- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për

përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”,

- Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”,
- Ligjit 10081 datë 23.02.2009 “Për Licensat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”
- Ligjit 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”
- Ligjin 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,
- Ligjin nr 93/2015 “Për turizmin”
- Ligjin nr 8098 datë 23.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, Ligji nr 9506 datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, Ligjit nr 8153 datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit”
- Ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar,
- Ligjin 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligjin 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”,
- Ligjin nr 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”,
- Ligjin nr 10296 “Për manaxhimin financiar dhe kontrollin”,

Për vitin 2024 Bashkia ka parashikuar të ardhura nga taksat dhe tarifave vendore të cilat përbëjnë rreth 37 % të totalit të të ardhurave të vitit 2024.

Pjesa më e rëndësishme e këtyre të ardhurave janë të ardhurat nga:

- Tarifave të shërbimit për komunitetin me 34.16 %. Në këtë zë, janë përfshirë: *Tarifa e manaxhimit të mbetjeve dhe tarifa e shërbimit,*
- Taksat e pasurisë me 33.00 %. Në këtë zë janë përfshirë taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe taksa e truallit
- Zërat e tjerë të taksave dhe tarifave vendore zënë rreth 32.8% të totalit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore.


Më poshtë po paraqesim pasqyrën përmbljedhëse të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022, të pritshmin e 2023 dhe tre vitet në vazhdim përfshirë vitin aktual të hartimit të buxhetit:

Tabelë e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifave vendore 2024-2026

Parashikimi dhe vleresimi I te Ardhurave 2024-2026

Nr		Emërtimi I të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	Plan buxhet	Parashikimi		
				2023	2024	2025	2026
I		Të Ardhura nga Taksat	434,568	401,449	446,656	452,375	452,375
1	7029200	Taksë kalimi pronësie	9,954	15,918	16,077	18,000	18,000
2	7002200	Tatim i Thjeshtuar	1,224				
3	7020100	Toka Bujqësore	76,766	79,591	88,426	88,426	88,426
4	7204101	Taksë rregj Automjete	81,091	67,774	78,244	82,040	82,040
5	7035009	Taksë tabele	2,839	531	2,920	2,920	2,920
6	7035002	Taksë zenie (tregu)	14,461	4,245	18,200	18,200	18,200
7	7020200	Taksë Ndërtese	135,848	121,961	123,181	123,181	123,181
8	7035003	Taksë ndikimi në infrastrukturë	58,343	69,128	71,000	71,000	71,000
9	7035008	Taksë reklame	18	2,506	2,531	2,531	2,531
10	7035005	taksë fjetje në hotel	35	1,592	1,608	1,608	1,608
11	7020600	Taksë Trualli	14,333	6,367	6,431	6,431	6,431
12	7204102	Pjesë nga TAP	39,656	31,836	38,038	38,038	38,038
13	7035015	Taksë e përkohshme(arsimi)					
II		Të Ardhura nga Tarifat	297,590	421,301	461,809	457,912	459,572
1	7110501	Tarifë pastrimi	150,415	297,338	304,650	304,650	306,650
2	7035010	Tarifë gjelbërimi	38,650	8,146	5,676	1,574	1,660
3	7035023	Tarifë ndricimi	349				
4		Tarifë te vitit(paketa)					
5		Tarifë Therje					
6	7111007	Tarifë parkimi	10,282	3,032	16,357	16,357	16,357
7	7110106	Tarifë transporti	7,387	7,000	7,070	7,070	7,070
8	7109200	Qira trualli,shfrytezim pyje	5,732	300	303	303	303
9	7109100	Qira tokë bujqësore	2,940	10,000	10,100	10,100	10,100
10	7111002	Tarifë cerdhe	1,720	5,094	5,145	5,145	5,145
11	7113003	Konvikte	4	558	564	564	564
12	7111001	Kopshte	17,073	12,389	27,507	27,507	27,507
13		Të tjera	21,691	31,836	33,947	33,947	33,521
14	7109600	Qira objekti	7,161	7,000	7,070	7,070	7,070
15	7115499	Gjoha MZSH		1,000	5,436	5,436	5,436
16		Gjoha Pol Bash. INUV	100	6055	6116	6116	6116
17		Gjob tatime	6,175	5023	5073	5073	5073
18	7204100	Rentë minerare	27,911	26,530	26,795	27,000	27,000
III		Totali taksa+tarifa	732,158	822,750	908,464	910,287	911,947

Sic shihet dhe nga tabela, për vitin 2024 niveli i të ardhurave nga taksat vendore është 446,656,000 lekë, ndërsa niveli i të ardhurave nga tarifave vendore është 461,809,000 lekë. Pesha specifike e taksave dhe tarifave vendore në totalin e të ardhurave të siguruara nga vetë Bashkia Fier për vitin 2024 paraqitet grafikisht si më poshtë:




A. NUMRI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE

Bashkia Fier ka gjithsej 67,542 familje taksapaguese, 5882 biznese dhe 35 institucione shtetërore. Të dhënat janë marrë nga regjistrat e gjendjes civile në qytet dhe në njesitë administrative dhe nga të dhënat e regjistarave të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Më poshtë pasqyrohen numri i taksapaguesve sipas njësive administrative dhe rajoneve të Bashkisë Fier.

Nr	Njësia Administrative	Familjet	Bizneset	Institucione
1	Rajoni N.1	6,746	1,114	5
2	Rajoni N.2	9,089	1,015	4
3	Rajoni Nr.3	8,764	865	7
4	Rajoni Nr.4	8,032	1,438	15
5	NjA Cakran	4,497	110	1

6	NJA Dermenas	3,930	80	
7	NJA Frakull	2,934	110	
8	NJA Libofshe	3,041	170	1
9	NJA Levan	8,087	230	1
10	NJA Mbrostar	3,130	200	
11	NJA Portez	3,165	240	
12	NJA Qender	3,720	220	
13	NJA Topoje	2,407	90	
	Totali	67,542	5,882	34



Sic shihet nga tabela dhe grafiku i mësipërm peshën më të madhe me 93% e zënë taksapaguesit familjarë dhe me 7% e zë biznesi.

A.1. NUMRI I TAKSAPAGUESEVE FAMILJARE

Numri gjithsej i taksapagueeseve familjarë është 67,542 familje, e cila si thame dhe më sipër ka peshën më të madhe të numrit të taksapagueeseve të Bashkisë Fier.

Shperndarja e taksapagueeseve familjarë në rajonet e qytetit dhe njërive administrative është përkatësisht 48.4% dhe 51.6%

Ne kater rajonet e qytetit numri eshte 32,631 familje taksapagueese, ndersa ne njesite administrative eshte 34,911 familje.

Ne evidentimin e kryer del se ka familje te cilat perfitojne lehtesira fiskale ne mbeshtetje te pika 6 e nenit 22 te Ligjit Nr. 9632, date 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar i cili cito nder te tjera se" 6. *Përfashtohen nga taksa mbi ndërtesat: e) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë; f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;*

Më poshtë paraqitet pasqyra e taksapagueseve familjarë sipas ngarkesës fiskale.

Nr	Njësia Administrative	Nr Familje	Familje me pagesë te plotë	Familje me lehtësi fiskale	Pensionistë, invalidë etj	Përfitues ndihmë ekonomike
1	Njësi administrative	34911	32831	2080	1100	980
2	Rajone Qytet	32631	25841	6790	3800	2990
	Totali	67542	58672	8870	4900	3970

Referuar tabelës së mësipërme, familjet me lehtësi fiskale janë 2080 familje në njësitë administrative dhe 6790 familje në rajonet e qytetit. Familjet me lehtësi fiskale zënë 13 % të totalit të familjeve gjithsej taksapaguese.

A.2 TAKSAPAGUESIT TE BIZNESIT

Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Tatimit Taksave dhe të dhënave të Qendres Kombëtare të Biznesit, numri i bizneseve që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë Fier është 5882. Biznesi i vogël zë rreth 78.2% të numrit total të bizneseve, ndërsa biznesi i madh zë 21.8% të numrit total të bizneseve.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset sipas kategorisë dhe shpërndarjes administrative .

Numri i bizneseve sipas kategorisë

Nr	Fusha e veprimtarisë	Njësi administrative	Bashki	Totali
1	Biznes i madh	224	1077	1301
2	Biznes i vogël	920	2738	3658
3	Biznes Transporti		923	923
	Totali	1144	4738	5882

Sic shihet nga pasqyra e mësipërme numri i bizneseve që ushtrojnë aktivitetin në njësità administrative është 1144 ose 19.4% të totalit të bizneseve, ndërsa numri i bizneseve që ushtrojnë aktivitetin në rajonet e qytetit të bashkise është 4738 ose 80.5% e totalit të bizneseve.


A.3 GRUPIMI I BIZNESIT TË MADH SIPAS NATYRËS

Në territorin e bashkisë ushtrojnë aktivitetin e tyre 1301 biznese të medha nga të cilat 224 biznese ushtrojnë aktivitetin në njësità administrative dhe 1077 biznese ushtrojnë aktivitetin e tyre në rajonet e bashkisë. Ky biznes është i shpërndarë sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr	Fusha e veprimtarisë	Njësi administrative	Bashki	Totali
1	Ndërtim	10	96	106
2	Prodhim	10	75	85
3	Profesion i lirë	4	13	17
4	Shërbim	75	274	349
5	Transport	25	28	53
6	Tregti	100	591	691
		224	1077	1301

Sic shihet dhe nga pasqyra, peshën më të e zë biznesi “Tregeti” me 691 biznese ose 53.1% kundrejt totalit, biznesi “Shërbim” me 349 biznese ose 26,8% kundrejt totalit. Vihet re se biznesi i madh është i përqëndruar në rajonet e qytetit të bashkise me rreth 82.8% të totalit.

Grupimi i biznesit të madh sipas natyrës




A.3 GRUPIMI I BIZNESIT TË VOGËL SIPAS NATYRËS

Në territorin e bashkisë ushtrojnë aktivitetin e tyre 3658 biznese të vogla. Ky biznes është i shpërndarë sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr	Fusha e veprimtarisë	Njësi administrative	Bashki	Totali
1	Ndertim	12	5	17
2	Prodhim	69	47	116
3	Profesion I lire	25	178	203
4	Shërbim	185	547	732
5	Transport	104	468	572
6	Tregëti	525	1493	2018
	TOTALI	920	2738	3658

Sic shihet dhe nga pasqyra e mësipërme biznesi vogël është i përqëndruar më shumë në rajonet e qytetit me 2738 biznese ose 74.8% dhe në njësitë administrative janë 920 biznese ose 25,1%. Vihet re se biznesi vogël me natyrë “Tregti” ka peshën më të madhe me 2018 ose 55.1%, biznesi i vogël me natyrë “Shërbim” me 732 ose 20%, biznesi i vogël me natyrë “Transport” me 572 ose 15.6%. Më poshtë po paraqesim grafikun e shpërndarjes së biznesit të vogël sipas natyrës në gjithë territorin e Bashkisë Fier.

Grupimi i biznesit të vogël sipas natyrës




B. TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat vendore parashikohen të mbledhen në vlerën 446,656,000 lekë ose rreth 51 % të totalit nga të ardhurat e taksave dhe tarifave vendore.

Pasqyra e të ardhurave nga taksat vendore

Nr	Emërtimi I të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	Plan buxhet	Parashikimi		
			2023	2024	2025	2026
I	Të Ardhura nga Taksat	434,568	401,449	446,656	452,375	452,375
1	7029200 Taksë kalimi pronësie	9,954	15,918	16,077	18,000	18,000
2	7002200 Tatim i Thjeshtuar	1,224				
3	7020100 Toka Bujqësore	76,766	79,591	88,426	88,426	88,426
4	7204101 Taksë rregj Automjete	81,091	67,774	78,244	82,040	82,040
5	7035009 Taksë tabele	2,839	531	2,920	2,920	2,920
6	7035002 Taksë zenie (tregu)	14,461	4,245	18,200	18,200	18,200
7	7020200 Taksë Ndërtese	135,848	121,961	123,181	123,181	123,181
8	7035003 Taksë ndikimi në infrastrukturë	58,343	69,128	71,000	71,000	71,000
9	7035008 Taksë reklame	18	2,506	2,531	2,531	2,531
10	7035005 taksë fjetje në hotel	35	1,592	1,608	1,608	1,608
11	7020600 Taksë Truallli	14,333	6,367	6,431	6,431	6,431
12	7204102 Pjesë nga TAP	39,656	31,836	38,038	38,038	38,038
13	7035015 Taksë e përkohshme(arsimi)					



Të ardhura nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë.

Kjo taksë administrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadasres në rolin e Agjentit Tatimor., ku 97% e vleres se cdo transaksioni i kalon bashkise. Planifikimi per vitin 2024-2026 është bërë mbështetur në ecurinë në vite të arketimit të kësaj takse. Ecuria e arkëtimit dhe parashikimit të kësaj takes paraqitet si më poshtë grafikisht:

Emertimi I te Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	I pritshmi 2023	Parashikimi		
			2024	2025	2026
Taksë e kalimit të pronësisë	9,954	15,918	16,077	18,000	18,000

Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Fier. Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit. Per 9-Njesite Administrative siperfaqja totale e taksuar eshte 192 578 196 m2 e ndare sipas kategorive perkatese. Me poshte po paraqesim pasqyren permbledhese sipas njesive administrative dhe kategorizimeve.

Pasqyra e taksës së tokës bujqësore sipas njësive administrative

Njesite administrative	Kategoria nr.1	Kategoria nr.2	Kategoria nr.3	Kategoria nr.4	Kategoria nr.5	Kategoria nr.6	Kategoria nr.7	Kategoria nr.8	Total N.J.A m/2
	K1/m2	K2/m2	K3/m2	K4/m2	K5/m2	K6/m2	K7/m2	K8-10/m2	
Levan	58,701	12,516,585	20,186,705	13,610,801	600,001	115,340	83,753	189,150	47,361,036
Mbrostar	10,080	828,000	1,736,000	490,000	197,000	20,130	20,290	0	3,301,500
Cakran	0	278,000	815,000	1,465,000	808,000	518,000	398,000	221,000	4,503,000
Topojë	80,860	10,061,960	14,310,776	4,954,238	664,180	1,590,768	2,932,616	0	34,595,398
Qender	200,000	1,990,000	18,160,000	8,400,000	2,700,000	2,700,000	1,600,000	0	35,750,000
Frakull	56,830	4,038,093	7,175,406	7,917,565	8,058,029	0	0	0	27,245,923
Libofshë	0	2,141,000	2,450,000	810,000	160,000	20,000	30,000	0	5,611,000
Dërmenas	2,600	242,000	49,900	1,081,000	51,500	46,000	2,800,000	0	4,273,000
Portëz	0	2,408,213	8,638,591	14,158,331	3,638,070	963,923	130,211	0	29,937,339
Totali kategori m/2	409,071	34,503,851	73,522,378	52,886,935	16,876,780	5,974,161	7,994,870	410,150	192,578,196
Cmimi per kategori m/2	0.50	0.44	0.38	0.32	0.27	0.22	0.16	0.16	
Totali per kategori	206,172	15,216,198	27,791,459	17,135,367	4,556,731	1,290,419	1,295,169	66,444	67,557,959

Pasqyra e taksës së tokës bujqësore sipas kategorive

Kategoria nr.1	409,071	0.50	206,171.78
Kategoria nr.2	34,503,851	0.44	15,216,198.29
Kategoria nr.3	73,522,378	0.38	27,791,458.88
Kategoria nr.4	52,886,935	0.32	17,135,366.94
Kategoria nr.5	16,876,780	0.27	4,556,730.60
Kategoria nr.6	5,974,161	0.22	1,290,418.78
Kategoria nr.7	7,994,870	0.16	1,295,168.94
Kategoria nr.8	410,150	0.16	66,444.30
Total NJ.A m/2	192,578,196		67,557,958.52
Detyrime ne vite			20,866,000
			88,423,959

Emertimi I te Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	I pritshmi 2023	Parashikimi		
			2024	2025	2026
Taksa e tokës bujqësore	76,766	79,591	88,426	88,426	88,426

Të ardhura nga taksa e rregjistrimit të automjeteve

Taksa llogaritet sipas përcaktimeve ne ligjin nr. 9975 dt. 28.07.2008, të ndryshuar " Për taksat kombëtare" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 18 datë 23.08.2011 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjedin e transportit.

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25 % të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit ku është Njësia e Qeverisjes Vendore..

Ecuria e mbledhjes së kësaj takse sipas parashikimit paraqitet si me poshtë grafikisht:

Emërtimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	I pritshmi 2023	Parashikimi		
			2024	2025	2026
Taksë rregj Automjete	81,091	67,774	78,244	82,040	82,040

Të ardhura nga taksa e tabelës

Bazuar në Ligjin 9632 datë 30.08.2006 kjo taksë aplikohet për tre lloje tabelash të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre e konkretisht: tabela për qëllime identifikimi; tabela për qëllime reklamimi dhe tabela për qëllime ekspozimi. Ecuria e mbledhjes se kesaj takse sipas parashikimit paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	I pritshmi 2023	Parashikimi		
			2024	2025	2026
Taksë table	2,839	531	2,920	2,920	2,920

Të ardhura nga taksa e zënies së tregut

Kjo taksë mblihet nga të ardhurat nga biletat për tregjet e lëvizshme dhe tregjet në njësitë administrative. Ecuria e mbledhjes së kësaj takse sipas parashikimit paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	I pritshmi 2023	Parashikimi		
			2024	2025	2026
Taksë zenie tregu	14,461	4,245	18,200	18,200	18,200

Të ardhura nga taksa e ndërtesës

Kjo taksë është një nga taksat e cila zë rreth 15% te totalit të të ardhurave nga taksat vendore. Baza e kësaj takse është sipërfaqja në m² e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për cdo kat. Edhe për këtë vit, për të rritur performancën e arkëtimit të kësaj takse, sidomos për kategorinë “familjarë”, Bashkia do të vazhdojë ta mbledhë këtë taksë me anë të Agjentit Tatimor, në ato vende ku ka kontrata me Ujësjetllës Kanalizime sh.a. dhe do të mbledhë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave detyrimet për kategorinë familjarë që nuk ka kontratë me UK sh.a.

Në zbatim të VKM nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “në vazhdimësi llogaritja e taksës së ndërtesës e kategorisë ‘Familjarë’” do të ketë ulje. Si rrjedhojë edhe parashikimet për këtë zë janë pothuajse në të njëjtin nivel me dy vitet e mëparshme.

Për llogaritjen e të ardhurave nga taksa e ndërtesës nga familjarët i referohemi faktit që megjithëse në tabelat e mësipërme numri i familjeve në njësitë administrative është pothuajse i barabartë me numrin e familjeve në qytet, sipërfaqja e banimit është më e madhe në rajonet e qytetit. Për rrjedhojë dhe niveli i të ardhurës nga kjo taksë është shumë më i lartë në qytet sesa nga njësitë administrative.

Në bazë të VKM nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme“, llogaritja e taksës së ndërtesës e kategorisë “Familjarë” është bërë si më poshtë:

Baza e taksueshme 53 100 lekë/m² x koeficienti 0.04 =21.24 lekë/m².

Per vitin 2022 faktikisht është evidentuar një rritje e të ardhurës nga kjo taksë, si rezultat i vjeljes së detyrimeve të prapambetura në vite. Për rrjedhojë, parashikohet që për vitin 2023, të të ardhurat të përlllogariten në nivelin e detyrimit dhe prandaj evidentohet një ulje në krahasim me të pritshmin e vitit 2022.

Nr	Emërtimi I të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	Plan buxhet	Parashikimi		
			2023	2024	2025	2026
1	Taksë Ndërtese	135,848	121,961	123,181	123,181	123,181

Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë

Edhe kjo taksë administrohet nga Bashkia. Ajo përcaktohet mbështetur në Ligjin 9632 me ndryshimet përkatëse. Ajo vilet edhe për ndërtimet e reja edhe për ato ndërtime që janë në proces legalizimi. Ecuria e mbledhjes së kësaj takse sipas parashikimit paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	I pritshmi 2023	Parashikimi		
			2024	2025	2026
Taksë e ndikimit në infrastrukturë	58,343	69,128	71,000	71,000	71,000

Të ardhura nga taksa e reklames dhe fjetje në hotel

Taksa e reklames parashikohet në të njëjtat nivele si në vitin e mëparshëm. Ndërsa e ardhura e taksës së fjetjes në hotel llogaritet nga numri i netëve të qëndrimit në hotel për person dhe përcaktohet me ligj. Kjo taksë administrohet nga Bashkia dhe panvarësisht se paguhet nga klienti, i derdhet Bashkisë nga subjekti hotel përkatës.

Të ardhura nga taksa e truallit

Taksa mbi truallin është një taksë e re që implementohet, që prej vitit 2016 dhe administrohet nga Bashkia. Me “truall” kuptohet një sipërfaqe toke, jo tokë bujqësore, që ndodhet brenda vijës

kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumentave ligjorë të planifikimit, të miratuar për të ndërtuar në të. Baza e taksës është sipërfaqja në m². Llogaritja e kesaj takse është bërë sipas ndarjes së kategorisë ‘biznes’ dhe ‘Familjarë’ dhe përkatësisht:

Nr	Emërtimi	Biznes			Familjarë			Totali
		Sipërfaqe/m2	cmimi	vlera	Sipërfaqe/m2	cmimi	vlera	
1	Taksa e truallit	296,489	20	5,929,780	895,035	0.56	501,220	6,431,000
		296,489		5,929,780			501,220	6,431,000

Të ardhura nga pjesa e Tatimit të Ardhurave Personale


Kjo është një taksë e re nga e cila Bashkia do të përfitojë edhe gjatë vitit 2024 në mbështetje të ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ku 2% e të ardhurave të arkëtuara nga të ardhurat personale të të punësuarve të Bashkisë Fier, e përfiton Bashkia Fier.

C. TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

Janë të ardhurat e siguruar nga tarifave vendore të vendosura me vendim të Këshillit të Bashkisë Fier në Paketën Fiskale dhe ato të miratuara rast pas rasti po me vendime të Këshillit të Bashkisë. Në Buxhetin e vitit 2024 është parashikuar të arkëtohen tarifa vendore në masën **461,809** lekë ose 51 % të totalit të të ardhurave vendore.

Pesha specifike e taksave dhe tarifave vendore në totalin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore paraqitet grafikisht si më poshtë:

Pesha Specifike e Taksave dhe Tarifave në totalin e të Ardhurave




Ecuria e të ardhurave nga tarifat vendore paraqitet në formë tabelare dhe grafikisht si më poshtë:

Nr		Emërtimi i të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	Plan buxhet	Parashikimi		
				2023	2024	2025	2026
II		Të Ardhura nga Tarifat	297,590	421,301	461,809	457,912	459,572
1	7110501	Tarifë pastrimi	150,415	297,338	304,650	304,650	306,650
2	7035010	Tarifë gjelbërimi	38,650	8,146	5,676	1,574	1,660
3	7035023	Tarifë ndricimi	349				
4		Tarifa te vitit(paketa)					
5		Tarifë Therje					
6	7111007	Tarifë parkimi	10,282	3,032	16,357	16,357	16,357
7	7110106	Tarifë transporti	7,387	7,000	7,070	7,070	7,070
8	7109200	Qira trualli,shfrytezim pyje	5,732	300	303	303	303
9	7109100	Qira tokë bujqësore	2,940	10,000	10,100	10,100	10,100
10	7111002	Tarifë cerdhe	1,720	5,094	5,145	5,145	5,145
11	7113003	Konvikte	4	558	564	564	564
12	7111001	Kopshte	17,073	12,389	27,507	27,507	27,507
13		Të tjera	21,691	31,836	33,947	33,947	33,521
14	7109600	Qira objekti	7,161	7,000	7,070	7,070	7,070
15	7115499	Gjoha MZSH		1,000	5,436	5,436	5,436

16		Gjoha Pol Bash. INUV	100	6055	6116	6116	6116
17		Gjob tatime	6,175	5023	5073	5073	5073
18	7204100	Rentë minerare	27,911	26,530	26,795	27,000	27,000

Plani i te ardhurave nga tarifat 2024-2026



Sic shihet edhe nga tabela krahasuese dhe grafikët përkatës, duket qartë se kemi një rritje të lehte të të ardhurave nga tarifat vendore përgjatë tre viteve të ardhshme, pasi kemi bere ndryshime ne paketen fiskale per vitet 2024 -2026 per kategoria e bizneseve
Zërat kryesorë të të ardhurave nga tarifat vendore janë:

- **“Tarifë e manaxhimit të mbetjeve”.** Kjo tarifë është parashikuar më vehte për vitin 2024, për vetë kërkesat e Ligjit për manaxhimin e mbetjeve. Ajo është përlllogaritur si kosto e ofrimit të shërbimit të manaxhimit të mbetjeve. Tarifa e manaxhimit të mbetjeve përlllogaritet 3000 lekë/familje në NJA e Qytetit dhe 2400 lekë/familje në NJA e tjera. **Vlen të theksohet fakti se kjo tarifë është e njëjtë me tarifën e vitit 2023, duke mos parashikuar rritje të detyrimit që qytetarët dhe bizneset do të paguajnë përgjatë vitit 2024.**
- **Tarifë shërbimi** e cila është një tarifë e përlllogaritur mbështetur në koston e ofrimit të shërbimeve të ndriçimit, gjelbërimit etj. Kjo tarifë është përlllogaritur 1000 lekë/familje në Qytet dhe 600 lekë/familje në fshat.
- **Tarifa e transportit** është një tarifë e cila paguhet nga njësitë ekonomike që pajisen me licensa transporti për automjete që përdoren për transportin urban (4+1;8+1 etj) dhe automjetet për transport mallrash. Duke qënë se numri i licensave nuk ka ndryshuar, edhe të ardhurat nga kjo tarifë janë pothuajse në të njëjtat nivele.


- *Tarifa e parkimit* është një tarifë e cila paguhet nga njesitë ekonomike dhe institucionet shtetërore për vendin që rezervojnë për parkimin e mjeteve të institucionit të tyre. për vitin 2024 e në vazhdim kemi parashikuar tarifë parkimi edhe për parkimet e reja që ka ndërtuar Bashkia Fier e konkretisht Parkimi nëntokësor pranë sheshit qendror të Qytetit dhe Parkimi te terminali i autobuzëve, pranë ish stacionit të trenit.
- *Tarifat nga dhënia me qira e aseteve të bashkisë.* Në këtë zë janë përfshirë të ardhurat nga qiraja e truallit, qiraja e tokës bujqësore, qiraja e ambienteve dhënë të tretëve. Llogaritja e të ardhurave nga ky zë është bërë referuar sipërfaqes së tokës pa frut, tokës arë dhe sipërfaqes ndërtimore dhënë me qira të tretëve. Tarifa e aplikuar për njësi m² është zbatuar referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 54 date 05.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Bazuar në kontrata sipërfaqe e dhënë me qira është

➤ Tokë pa frut	836,300 m ²
➤ Tokë arë	14,404 m ²
➤ Toke pemetore	220,000 m ²
➤ Te tjera toka	20,000 m ²
➤ Sipërfaqe objekte me afat një vjeçar	578 m ²
➤ Sipërfaqe objekte me afat shumë vjeçar	1,973.28 m ²
- *Të ardhurat nga kuota ushqimore në konvikte, kopshte, çerdhe.* Ecuria e mbledhjes së të ardhurave nga kuota ushqimore për konviktet, çerdhet dhe kopshtet është rritur pasi janë rritur cmimet e ushqimeve të transportit dhe të tjera. Llogaritja e këtyre të ardhurave bëhet në bazë të kuotave ditore të ushqimit dhe pjesëmarrjes së femijëve dhe nxënësve në kopshte, çerdhe e konvikte. Këto të ardhura përdoren për blerje ushqimesh, inventar ekonomik dhe kryerjen e shërbimeve të tjera në funksion të cilësive të kushteve dhe ushqimit në këto institucione.
- *Tarifa nga gjoba INUV, tatime, polici bashkiake e MZSH.* Të ardhurat që mbildhen nga këto tarfa janë kryesisht gjoba të cilat vendosen nga Inspektoriati i Ndërtimit pranë Bashkisë Fier për shkelje të konstatuara nga subjektet që janë në proces ndërtimi. Po kështu edhe gjobat që vendos policia bashkike ndaj subjekteve të cilat tregtojnë në vende që nuk janë të përcaktuara për tregtim dhe kundërvajtjet e tjera administrative. Gjithashtu edhe nga MZSh vendosen gjoba për masën e sigurisë në objekte për mbrojtjen nga zjarri. MZSh siguron të ardhura nga vendosja e tarifës për shërbime të përcaktuara me ligj për këtë institucion si leje sheshi, akt teknik, akt ekspertimi.
- *Renta minerare* Kjo e ardhur është e përcaktuar sipas Ligjit për Taksat Kombëtare për prodhimin dhe nxjerrjen nga nëntoka e produkteve të saj, ku 5% e të ardhurave të shfrytëzimit i kalohet bashkisë e cila ka në juridiksionin e saj territorin që shfrytëzohet për nxjerrje e produkteve të nëntokës.
- *Të ardhura nga tarifa e shërbimit të varrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike. me Vendimin nr 50 datë 23.07.2021* ka vendosur që shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave

publike dhe shërbimi i varrimit të kryhet nga Bashkia Fier. Në këtë kuadër është ngritur tashmë Ndërmarrja e Gjelbërimit, Mirëmbajtjes së varrezave Publike dhe shërbimit të varrimit. Për këtë qëllim është përlogaritur një tarifë e cila përfshin: Shërbimin e kryerjes së procesit të varrimit dhe jo tarifat e shoqërive private të funeralit.

- *Tarifa te tjera.* Në këtë zë janë përfshirë kryesisht të ardhurat nga shërbime dytësore që nuk janë përfshirë në zërat e tjerë të tarifave. Në vecanti janë përfshirë shërbime ndaj komunitetit si pajisja me vërtetime ëe ndryshme si në Njësitë Administrative ashtu dhe në Rajonet e qytetit, nxjerrja dhe fotokopje e dokumentave dhe vënia në dispozicion të qytetarit, e të tjera shërbime të parashikuara në paketë n fiskale, taksën e pullës, sponsorizime etj.

Pesha specifike e secilës tarifë në totalin e tarifave vendore paraqitet grafikisht si më poshtë:



V. Të Ardhurat nga Transfertat Specifike

Të ardhurat e Bashkisë Fier për vitin 2024, që do të sigurohen nga transfertat specifike, janë financime të funksioneve të deleguara nga Ministria e Financave për konviktet e arsimit parauniversitar, për arsimin parashkollor, arsimin parauniversitar, mbrojtjen nga zjarri, ujitjen e kullimin, administrimin e pyjeve dhe rrugët rurale.

Funksionet që financohen me transfertat specifike për vitin 2024 janë :


Konviktet e arsimit parauniversitar. Në transfertën specifike të vitit 2024, bashkive iu akordohen fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe kujdestarë) dhe shpenzimet operative. Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1710, datë 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 502, datë 16.04.2008”, për punonjësit edukative (zëvendës drejtor dhe edukator). Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

- Fondi i akorduar për konviktet e arsimit parauniversitar është **22,809,000 lekë**
- *Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor.* Në transfertën specifike të vitit 2024, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor të ndarë për personelin mësimor në vlerën **196,399,000 lekë** ku përfshihet pagat e edukatoreve të kopshteve dhe pagat për stafin e QKF (*Qendra kulturore e fëmijëve*) gjithashtu përfshihen dhe pagat për stafin mbështetës të arsimit parashkollor si sanitarë, rojet e objekteve të shkollave në vlerën **50,848,000 lekë**.
- *Per arsimin parauniversitar.* Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar përfshihen pagat për sekretarët e shkollave të mesme, sanitarët dhe disa roje shkollash të mesme. Fondi i akorduar për këtë funksion është **13,439,000 lekë** për personelin parauniversitar.
- *Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH).* Në transfertën specifike të vitit 2024, janë fondet për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Fondi i akorduar për këtë funksion nga transfertat specifike është **39,455,000 lekë**.
- *Rrugët rurale.* Në transfertën specifike të vitit 2024, janë fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet investime në rrugët rurale. Fondi i akorduar për këtë funksion nga transfertat specifike për vitin 2024 është **10,542 000 lekë**.

- *Administrimi i pyjeve.* Në transfertën specifike të vitit 2024, janë fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjese fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve, si dhe shpenzimet operative. Fondi i akorduar për këtë funksion nga transfertat specifike është **4,810,000 lekë**. Vlen të theksohet fakti se ky fond është i pamjaftueshëm për kryerjen e këtij funksioni. Fondi është i pamjaftueshëm për pagat e punonjësve të Drejtorisë së Pyjeve dhe rojeve të pyjeve. Kështu që Bashkia Fier ka qenë e detyruar të mbulojë edhe shpenzimet për paga edhe shpenzimet operative për kryerjen e këtij funksioni.
- *Ujitja dhe Kullimi.* Në transfertën specifike të vitit 2024, janë fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Fondi i akorduar për këtë funksion nga transfertat specifike është **66,917,000 lekë**.
- *Mbrojtja Sociale.* Në transfertën specifike të vitit 2024, janë alokuar fonde për Qendrën Multifunkcionale Horizont. Është i treti vit që Bashkia përfiton të ardhura nga Buxheti i Shtetit për këtë qëndër. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative dhe kapitale të nevojshme për këtë shërbim të Bashkisë. Vlen të theksohet fakti që këtë shërbim Bashkia Fier e ofron falas. Fondi i akorduar për këtë funksion nga transfertat specifike për vitin 2024 është **27,589,000 lekë**.

Fondet e planifikuara të financuar me Transfertën e Pakushtëzuar Sektoriale, paraqiten si më poshtë:

Transferta sektoriale per vitin 2024



Sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Financave përlogaritjet e vlerës së të ardhurave nga Transferta specifike parashikohet për PBA 2024-2026 si më poshtë:


Nr	Emërtimi I të Ardhurave Tatimore	Fakti 2022	Plan buxhet	Parashikimi		
			2023	2024	2025	2026
2	Transfertë Specifike	401,518	402,079	432,809	432,809	432,809

Të ardhurat nga Transferta e Pakushtëzuar

Të ardhurat e Bashkisë Fier për vitin 2024, që do të sigurohen nga Transferta e pakushtëzuar, i janë bërë të ditura Bashkisë nga Ministria e Financave. Transferta e paushtëzuar që do i alokohet Bashkisë Fier gjatë vitit 2024, është përcaktuar 889,876,000 lekë me një rritje absolute prej 151,858,000 lekë ose rreth 121% më shumë, krahasuar me vitin 2023.

Gjithashtu mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e Buxhetit afatmesëm 2024-2026, i janë njoftuar Bashkisë Fier edhe fondet e transfertës së pakushtëzuar për vitet 2024-2026, të cilat evidentohen në rritje për çdo vit buxhetor sipas grafikut të mëposhtëm

Ecuria e transfertes se pakushtezuar ne vitet 2019-2024



Sic edhe shihet nga Grafiku i mësipërm, Transferta e Pakushtëzuar ka ardhur në rritje. Kjo si pasojë e formulës së përlogaritjes së Transfertës e lidhur kjo ngushtësisht me numrin e popullsisë, numrin e nxënësve, sipërfaqet etj.

VI. Të Ardhura të Trashëguara

Nga përlogaritjet e kryera gjatë kësaj periudhe të shpenzimeve të nevojshme për tu financuar deri ne fund te vitit 2023 dhe nga gjendja aktuale e llogarive ne Degën e Thesarit rezulton se të ardhurat

që do të trashëgohen në vitin 2024 janë rreth **250,000,000 lekë**. Ky tregues do të saktësohet në mbyllje të bilancit financiar të vitit 2023 dhe është varësi direkte e likuidimit të detyrimeve kontraktuale deri në 31.12.2023.

Në analizë të të gjithë treguesve që analizuam më sipër rezulton se plani total i të ardhurave të Bashkisë Fier për Vitin 2024 është 2,481,150,000 lekë.

Theksojmë edhe njëherë se treguesi i të ardhurave është ambicioz dhe realizimi total i tyre do ti sigurojë një frymëmarrje të re komunitetit të Bashkisë Fier.

VII. Parashikimi i Shpenzimeve të Bashkisë Fier për vitin 2024.

Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2024 është **2,481,150,000 lekë**. Gjatë vitit 2024 përmes këtyre shpenzimeve Bashkia Fier synon të arrijë të përmbushë të gjitha funksionet e përcaktuara me Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore, sinjalistikën rrugore.
- Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm
- Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet të zonave të banuara.
- Planifikimi administrimi dhe kontrolli i territorit, sipas përcaktimeve të ligjit
- Ndricimin e mjediseve publike
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.
- Shërbimin e dekorit publik.
- Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të arsimit të sistemit shkollor me përjashtim të shkollave profesionale
- Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte e cerdhe.
- Rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor.
- Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane
- Parqet, lulishte dhe hapësirat e gjelbërta
- Administrimin e qendrës sociale për personat me aftësi ndryshe
- Zhvillimin e aktiviteteve kulturore artistike për promovimin e identitetit kombëtar e lokal.
- Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.
- Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- Funksionet në nivel vendor për mbrojtjen e mjedisit.
- Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujtitjes dhe kullimit.

- Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore
- Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik.
- Mbrojtjen civile në nivel vendor.
- Garantimi i shërbimit zjarifikës.


Shpenzimet përmbledhëse sipas kategorive ekonomike dhe Njësive të varësisë së Bashkisë Fier paraqiten në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabelë Përmbledhëse për Programet Buxhetore sipas viteve 2024

ne 000 leke

Nr	Emertimi i Programit Buxhetor	Kodi I programit buxhetor	Realizimi I 2022	I pritshmi 2023	Buxheti 2024
1	Planifikim Menaxhim Administrim	01110	611,784	989,412	851,383
2	Emergjencat Civile	01110	19,650	60,680	99,246
3	Mbrojtja nga zjarri	03280	29,325	37,029	39,455
4	Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit	04240	59,027	70,497	85,217
5	Menaxhimi I pyjeve dhe kullotave	04260	3,915	4,361	4,810
6	Rrjeti rrugor	04520	75	9,462	10,542
7	Zhvillimi I komunitetit(<i>mbetjet e ngurta</i>)	05100	204,195	243,981	214,400
8	Zhvillimi I komunitetit (<i>shërbimet publike vendore</i>)	06260	221,542	274,131	276,136
9	Zhvillimi I komunitetit (<i>shërbimet rurale</i>)	06260	60,935	69,387	77,086
10	Gjelberimi, Higjena dhe Mirembajtje Varreza Publike	06260	93,939	95,350	185,286
11	Shërbimet kulturore	08220	74,013	80,923	78,657
12	Arsimi parashkollor	09120	211,751	217,389	240,248
13	Arsimi parauniversitar (konvikte)	09230	30,511	34,046	36,248
14	Qendra e kujdesit Social	10430	14,917	27,040	27,154
15	Arsimi administrata dhe cerdhet	10430	134,340	225,826	255,282
	Totali		1,769,919	2,439,514	2,481,150

-----Paraqitja Grafike e Buxhetit per vitin 2024



Parashikimi i Numrit të punonjësve për vitin 2024

Gjatë vitit 2024 Bashkia Fier parashikon qe numri i punonjësve të jetë 1509 punonjës gjithsej. Gjate vitit 2023 ka patur levizje të numrit të punonjësve midis njësive të ndryshme shpenzuese, dhe njëkohësisht ndryshime në numrin e përgjithshëm të punonjësve për efekt të disa ndryshimeve strukturore si shpërndarja e punonjësve ndermjet ndermarrjes se Pastrimit dhe Ndermarrjes se gjelberimit dhe konkretisht sektori I higjenes, shkurtimi I drejtoreve te pergjithshem etj. **Në total me gjithë shtëpinë e të moshuarve Bashkia Fier parashikon të ketë 1533 punonjës.**

Përlogaritjet për fondin e pagave të punonjësve dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore të tyre është bërë mbështetur në:

- ✓ Ligjit për Sigurimet Shoqërore dhe shëndetësore

- ✓ Nivelit të pagave të miratuara me Vendim të Këshillit të Bashkisë Fier të miratuar sipas VKM datë Nr 165 datë 02.03.2016
- ✓ Ligjit Për Tatimin mbi të Ardhurat
- ✓ Numrit të Punonjësve të parashikuar
- ✓ Pagës mesatare që rezulton sipas përlllogaritjeve.
- ✓ Tabelën aktuale të pagave të miratuara me Vendim të Këshillit të Bashkisë.

Të dhënat për Numrin e Punonjësve dhe Pagën Mesatare sipas Njësive Shpenzuese jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë për Numrin e Punonjësve të Bashkisë Fier dhe të Ndermarrjeve vartëse për vitin 2024

Nr	Emertimi i Institucionit	Nr punonjësve	Paga mesatare neto	Fondi I pagave	Sigurimet Shoqërore	Total shpenz. Pun.
1	Shuma Bashkia Aparati 2111001	353	70,101	296,948,617	49,590,419	346,539,036
2	Drejtorja e Artit dhe Kultures	57	62,936	43,048,224	7,189,053	50,237,277
3	Ndermarrja Sherbimeve Publike	172	49,752	102,687,124	17,148,750	119,835,874
4	Ndermarrja e Pastrimit	135	52,049	84,319,380	14,081,336	98,400,716
5	Qendra Ekonomike e Arsimit	514	59,297	365,742,538	61,079,004	426,821,542
6	UjtitjadheKullimi	53	54,297	34,533,133	5,767,033	40,300,167
7	Ndermarrja e Sherbimeve Rurale	35	53,372	22,416,080	3,743,485	26,159,565
8	Ndermarrja e gjelbermit dhe mirmbajtjes se varrezave publike	194	50,611	117,822,408	19,676,342	137,498,750
	Totali	1513	77,019	1,067,517,504	178,275,423	1,245,792,927

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme shpenzimet për punonjësit kapin vlerat si më poshtë:

- ✓ Pagat e punonjësve përlllogariten në vlerën prej 1,067,517,504 lekë
- ✓ Sigurimet shoqërore përlllogariten në vlerën prej 178,275,423 lekë
- ✓ Shpenzimet totale për punonjësit kapin vlerën 1,245,792,927 lekë

Në total shpenzimet për punonjësit zënë 50.2% të totalit të shpenzimeve të Buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2024 megjithëse pagat e punonjësve janë rritur sipas VKM që hyn në fuqi gjatë vitit 2023 për qindja që zënë pagat e punonjësve janë 0.1 % më të ulta ndaj totalit të Buxhetit këtë vit nga sa kanë qene të planifikuara gjatë vitit 2023

Parashikimi i Shpenzimeve Operative

Shpenzimet operative për vitin 2024 janë programuar mbështetur në të pritshmin e vitit 2023, kërkesat e Njësive shpenzuese përkatëse, fondet në dispozicion të Bashkisë për vitin 2024. Analitikisht kërkesat, parashikimet dhe buxheti paraqiten në tabelën e mëposhtme:


Parashikimi i Shpenzimeve Operative për Gjithë Njësitë në varësi të Bashkisë Fier

Tabelë Përmbledhëse për shpenzimet operative (602) sipas Programeve Buxhetore per vitin 2024

		000 lekë
Nr	ProgrametBuxhetore	Buxheti 2024
1	PlanifikimMenaxhimAdministrim	125,908
2	Emergjencat Civile	99,246
3	Mbrojtja nga zjarri	4,455
4	Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	26,617
5	Qendra e Kujdesit Social	5,130
6	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	296
7	Rrjeti rrugor	
8	Zhvillimi i komunitetit (<i>mbetjet</i>)	87,000
9	Zhvillimi i komunitetit (<i>shërbimet publike vendore</i>)	130,000
10	Zhvillimi i komunitetit (<i>shërbimet rurale</i>)	42,626
11	Gjelbërimi dhe mirëmbajtje varreza publike	23,986
12	Shërbimet kulturore	27,920
13	Arsimi parashkollor (edukator kopshte etj)	
14	Arsimi parauniversitar (Konvikte kujdestar etj)	3,674
15	Arsimi mbështetës (Administrat dhe çerdhet)	93,582
	Totali	670,440

